



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës *Ex Parte*

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mathju Halling

Valeria Boliçi

Xhejms Paç

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli



TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në pajtim me nenin 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 116(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 tetor 2021, Trupi Gjykses i informoi palët se do të lëshohet një vendim përmbledhës për aspektet ende të pasqaruara¹ të rregullës 102(3) sa më shpejt që të jetë e realizueshme, gjatë apo menjëherë pasi të dëgjoheshin dëshmitë e dëshmitarëve W04841 dhe W04842. Trupi Gjykses vuri në dukje se kjo shtyrje ishte e nevojshme sepse rëndësia materiale dhe nxjerrja e materialeve të rregullës 102(3) lidheshin ngushtë me pretendimet e Mbrojtjes për shtyrje dhe për shkak se, nëse dëshmitarët W04841 dhe W04842 do të mund të jepnin dëshmi në lidhje me pretendimet për shtyrje, dëshmitë e tyre mund të ndikonin në vendimin e Trupit Gjykses².

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Në bazë të rregullës 116(4) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të nxjerrë urdhra për çdo aspekt që nevojitet për të garantuar një gjykim të drejtë dhe të shpejtë.

¹ F00307, Prokurori i Specializuar, *Shtesë e Njoftimit Përmbledhës të Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) me Shtojcën Konfidenciale 1*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; shih gjithashtu F00307/RED, publik; F00316, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtime të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("Parashtrimi i ZPS-së i datës 17 shtator 2021"), 17 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; shih gjithashtu F00316/RED, publik; F00361, Prokurori i Specializuar, *Përditësim i Prokurorisë i Shtesës së Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 13 tetor 2021, konfidencial.

² Version pune i transkriptit, 18 tetor 2021, f. 816-817.



III. DISKUTIM

3. Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të dëgjojë parashtrimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") në lidhje me aspektet ende të pazgjidhura të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) dhe masat e mundshme kompensuese. Trupi Gjykues vëren se temat që duhen diskutuar përmbajnë informacion tejet të ndjeshëm nga hetimet që janë në kryerje e sipër dhe që lidhet me sigurinë e dëshmitarëve, si dhe material që është objekt i një kërkesë për mosnxjerrje informacioni, për të cilën ende nuk është marrë një vendim³.

4. Për këtë arsye, Trupi Gjykues urdhëron që seanca *ex parte* me ZPS-në të mbahet më 21 tetor 2021, në orën 14:30. Detaje të tjera për lëndën që do të trajtohet në këtë seancë jepen në shtojcën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të këtij urdhri.

IV. VENDIM

5. Për arsyet sa më lart, Trupi Gjykues **VENDOS** të mbajë një seancë *ex parte* vetëm me ZPS-në më **21 tetor 2021, ora 14:30**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 19 tetor 2021

Në Hagë, Holandë

³ Parashtrimi i ZPS-së i datës 17 shtator 2021; *shih gjithashtu* F00316/RED, publik.